



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**i mbledhjes së parë të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 22.5.2026, me fillim në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Oktay Kurtesh, Lindita Rexhepi, Nenad Miladinovic, Mirsada Behluli, Feim Osmani, Kimeta Shok, Betim Abdullahu, Adnan Ajeti.

**Munguan:** Faton Marolli.

**Në mbledhje morën pjesë edhe:** Qefsere Berisha Veseli, zyrtare nga ZKKK-s, Valentina Mehmeti, zyrtare nga ZKKK-s, Klaudia Mula, zyrtare nga Drejtoria e Arsimit, Florent Salihu, zyrtar nga UNMIK-u, përfaqësues nga KFOR-i.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesi i Komitetit z. Oktay Kurtesh me këtë:

### REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z. Leutrim Retkoceri (gjendja me mbeturina në kryeqytet);
3. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, z. Arianit Elshani (informatë për gjendjen e sigurisë aktuale në shkolla ku vijnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë);
4. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Kadastrit dhe legalizimit, Gent Begolli (evidentimi i pronave për komunitetet joshumicë, mënyra e trashëgimisë, korrigjimet e numrave personalë në certifikatat e pronës);
5. Analiza e punës dhe shqyrtimi i aktiviteteve të Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2026;
6. Raporti i punës së ZKKK-ës për vitin 2025;
7. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre;
8. Të ndryshme.

Faqe 1 nga 8

## **Pika e parë**

### **Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

## **Pika e dytë**

### **Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z. Leutrim Retkoceri (gjendja me mbeturina në kryeqytet).**

**Betim Abdullahu:** – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se pasi që drejtori i lartëpërmendur nuk është prezent në takim dhe nuk ka dërguar ndonjë zyrtar nga drejtoria, tha se që secili anëtar i komitetit që ka ndonjë kërkesë apo ankesë për t'i parashtruar drejtorisë përkatëse me i paraqitur këtu në takim, ku pastaj së bashku me ZKKK, me qytetarët e komuniteteve që jetojnë në Prishtinë t'i adresojë te drejtoria përkatëse.

**Nenad Miladinovic:** - tha se sa i përket pikës së dytë kisha me i theksuar disa probleme, por nëse planifikohet që të kalojmë në pikën e tretë atëherë më vonë mund të merremi me pikën e dytë.

**Kimeta Shok:** – lidhur me mospjesëmarrjen e drejtorëve në takim ne duhet të ndërmarrim diçka që të mos përsëritet si herëve të kaluara, pasi që ata duhet të vijnë në takim që kur t'i shtrojmë shqetësimet tona të jenë ata prezentë.

**Mirsada Behluli:** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se kisha me i falënderuar përfaqësuesit e KFOR-it, të cilët na vizitojnë gjithmonë dhe interesohen për problemet dhe shqetësimet tona. Ajo mes tjerash ceku edhe problemin e çështjes së mbeturinave ku në disa vende në lagjen ku ajo jeton tha se gjendja me mbeturina është alarmante, ku këtë gjendje e kanë parë edhe vetë përfaqësuesit e KFOR-it dhe sot më kanë informuar se kanë intervenuar për pastrimin dhe mbledhjen e mbeturinave, gjë për të cilën i falënderoj shumë.

**Feim Osmani:** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se po ashtu i bashkëngjitem përshëndetjes për KFOR-in që gjithnjë me aq sa kanë mundësi kanë qenë afër komuniteteve.

**Nenad Miladinovic:** - sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës tha se meqë përfaqësuesin e drejtorisë përkatëse nuk e kemi prezent në takim, mirëpo problemet në përgjithësi me shërbime publike kemi. Ai në vazhdim tha se kisha me u fokusuar në dy problemet që i përkasin Bërrnicës dhe rrethinës, ku ato janë problemet e të gjithë neve e jo vetëm të komunitetit serb. Së pari kisha me u fokusuar në hedhjen ilegale të mbeturinave që kohëve të fundit është bërë alarmante dhe ka marrë përmasa të gjera dhe sipas mendimit tim është jashtë kontrollit që kështu nuk ka qenë asnjëherë më parë. Mirëpo është një gjë që nuk mund ta kuptoj se drejtoria e lartëpërmendur do duhej të ishte më aktive kur janë në pyetje kushtet për jetesën e qytetarëve. Prandaj kisha me e lutur përfaqësuesin përgjegjës si dhe kryetarin e komunës të ndërmarrin diçka lidhur me këtë çështje pasi që duke e pasur parasysh se janë duke u shpërndarë viruse të ndryshme.

**Kimeta Shok:** – lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës propozoi që të ftohet edhe njëherë Drejtoria e Shërbimeve Publike.

#### **Pika e tretë**

**Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, z. Arianit Elshani (informatë për gjendjen e sigurisë aktuale në shkolla ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë)**

**Klaudia Mula:** – sa i përket kësaj pike tha se në vazhdimësi i monitorojmë shkollat, por kemi kërkuar edhe raport me shkrim nga ato. Pra janë disa shkolla ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë si p.sh shkolla “Qamil Batalli” apo shkolla “Model”, e cila i ka nëntëdhjetë (90) nxënës të komunitetit ashkali, SHFM “Pjetër Bogdani”, i ka katër (4) nxënës nga komuniteti ashkali, shkolla “Elena Xhika” i ka dyqind e dyzet e tre (243) nxënës të komuniteti turk, shkolla “Emin Duraku” katërmëdhjetë (14) nxënës të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, shkollat “Asim Vokshi” dhe “Zenel Hajdini” i kanë gjithsejtë tridhjetë e dy (32) nxënës të komunitetit ashkali, shkolla “Nexhmi Mustafa” i ka katër (4) nxënës të komunitetit rom, dhe shkolla “Naim Frashëri” i ka katërmëdhjetë (14) nxënës, 6 të komunitetit boshnjak, 3 sirian, 3 jordanez, 1 rom dhe 1 ashkali. Ndërsa sa i përket gjendjes së sigurisë nuk kemi pasur ndonjë ankesë rreth kësaj çështjeje, mirëpo ka pasur kërkesa për shtimin e numrit të psikologëve dhe mësuesve mbështetës si dhe në disa raste si p.sh në shkollën “Emin Duraku” sfidë është vijueshmëria jo e rregullt në mësim, me të cilën çështje merret sholla apo ekipi parandalues për braktisje. Pra kjo do të ishte një përmbledhje e raportit po nëse ka dikush diçka të pyes le të urdhëron.

**Mirsada Behluli:** – shtroi pyetje se a ka pasur braktisje të mësimin, pasi që e dimë se në vitin 2025 ka pasur braktisje nga një nxënës për shkak të martesës së hershme, si dhe ka pasur tendencë që edhe shtatë të tjerë ta braktisin shkollimin.

**Klaudia Mula** - sa i përket pyetjes së znj. Behluli tha se në bazë të këtij raporti vetëm shkollat “Emin Duraku” dhe “Asim Vokshi” e kanë shfaqur si sfidë vijueshmërinë jo të rregullt në shkollë, mirëpo nuk ka braktisje. Ajo në vazhdim tha se ekipet parandaluese për braktisjen e shkollës janë duke u marrë me rastet të cilat janë në rrezik për braktisje.

**Oktay Kurtesh:** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se më duket se çdo vit po ka raste të braktisjeve të mësimin në atë shkollë.

**Klaudia Mula:** - lidhur me diskutimin e z. Kurtesh tha se këto janë rastet e të gjitha komuniteteve ku arsyet janë të ndryshme siç e dini edhe ju. Kemi raste edhe tek komuniteti shqiptar tash që jemi duke u marrë decidivisht me ato raste që ligji parasheh edhe kallëzim penal për prindërit të cilët nuk i dërgojnë fëmijët në shkollë. Mirëpo janë mekanizmat që duhet kaluar që me shkuar deri në atë masë ligjore. Ajo në vazhdim tha se DKA-ja është e përkushtuar në këtë aspekt dhe është duke u munduar që ta bëjë punën sa më mirë që është e mundur që fëmijët të vijojnë shkollimin e obliguar.

**Nenad Miladinovic:** - sa i përket Klaudies personalisht nuk kam pyetje, mirëpo kam pyetje lidhur me diskutimin e koleges nga komuniteti goran lidhur me mosprezencën e drejtorëve në takim, ndoshta ka qenë edhe gabimi i ynë, por në të ardhmen kur ju dërgojmë ftesën drejtorëve për mbledhjen e Komitetit nuk duhet të jemi strikt që drejtori të jetë i pranishëm në takim pasi që ajo ka të bëjë me drejtorinë përkatëse pra mjafton të jetë edhe ndonjë zyrtar kompetent nga drejtoria, pasi që duhet kuptuar se drejtorët nuk mund të marrin pjesë gjithmonë në takim pasi që ata kanë edhe obligime tjera. Pra sot kemi pasur shembullin konkret nga Drejtoria e Arsimit ku drejtori nuk ka pasur mundësi të marrë pjesë në takim dhe e ka autorizuar Klaudien si përfaqësuese nga drejtoria të marrë pjesë në takim. Pra në të ardhmen kur t'i drejtojmë ftesat për drejtorë le t'i drejtohen drejtorisë përkatëse.

**Oktay Kurtesh:** – duke u ndërlidhur në diskutimin e z. Miladinovic tha se plotësisht pajtohem me propozimin e z. Miladinovic. Ai në vazhdim tha se edhe në të kaluarën kemi pasur prezent në takime zv. drejtorë apo zyrtarë të drejtorive përkatëse ka ndodhur që nuk na kanë dhënë ndonjë informatë konkrete vetëm se na i kanë marrë pyetjet dhe shqetësimet që i kemi parashtruar, ku për atë arsye kemi thënë se më mirë është të jenë drejtorët prezent në takim.

**Feim Osmani:** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se po ashtu edhe unë mendoj se do të ishte mirë që kërkesën me ua dërguar me kohë, si dhe kishte me qenë mirë që së paku shtatë ditë para takimit drejtorët ta kenë ftesën. Ndërsa sa i përket pjesëmarrjes do të ishte mirë që niveli sa më i lartë i përgjegjësisë të merr pjesë në komitet për arsye specifike që mundet me i bërë komiteti, pra kërkesave specifike dhe fuqisë për me vendosur në të mirë të kërkesave të anëtarëve të Komitetit.

Ai në vazhdim tha se për këtë çështje prania posaçërisht e drejtorëve të cilëndo drejtori çoftë i ndihmon shumë komitetit dhe nuk mendoj se duhet me ra në nivel më të ulët sesa drejtori, edhe pse kohën nuk ua kufizojmë se mund të jenë të pranishëm për një kohë të shkurt.

**Oktay Kurtesh:** - duke iu drejtuar znj. Mula tha se vitin e kaluar kam pasur një kërkesë për Drejtorinë e Arsimit që ka të bëjë për një klasë për parashkollor apo çerdhe për komunitetin turk në lagjen “Meto Bajraktari”, ku dhe kam premtimin se do të bëhet, prandaj më intereson se si mundemi ta hapim më shpejt. Ndërsa pyetja e dytë është për çerdhen “Yllkat” që ndodhet tek Shtëpia e Pleqve ku edhe aty ka një klasë me fëmijë të komunitetit turk, nëse ka mundësi t’ju sigurohet një tabelë me mbishkrim në gjuhën turke, siç është në shkollën “Elena Xhika” dhe “Sami Frashëri”.

**Klaudia Mula:** – duke u ndërlidhur në diskutimin e z. Kurtesh tha se këtë kërkesë për “Meto Bajraktar” e ke bërë në mënyrë fizike. Sa i përket kësaj çështjeje unë do t’ia përcjelli drejtorit dhe do t’ju njoftoj pastaj.

**Mirsada Behluli:** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se duke e pasur parasysh se kam qenë kryesuese e komitetit në mandatin e kaluar sa i përket kërkesave të shkollave ku vijojnë mësimin nxënësit e komunitetit joshumicë tha se shkolla “Emin Duraku” ka kërkesë për ndërtimin e amfiteatrit në oborrin e shkollës ku do të mbaheshin aktivitete të

ndryshme. Pastaj kemi shkollën fillore “Nexhmi Mustafa” e cila ka kërkesë për ndërtimin e objektit të ri në të cilën vijoje mësimin 518 nxënës, sepse objekti ekzistues nuk i përmbush kushtet elementare në asnjë aspekt. Ajo mes tjerash ceku edhe kërkesat nga komuniteti turk që kanë të bëjnë me mbajtjen e provimit të maturës dhe garat që testi të jetë në gjuhën turke. Pastaj kemi falënderim për organizimin e transportit pa pagesë për tetëdhjetë nxënës nga të gjitha komunitetet qysh kishin pasur më të lehtë vijimin në shkollë.

**Klaudia Mula:** – duke u ndërlidhur në diskutim lidhur me mbajtjen e garave të diturisë tha se janë mbajtur më datë 16 në nivel komunal, kështu që si lëndë ka qenë e përfshirë edhe gjuha turke, ku ka marrë pjesë një nxënës i komunitetit turk dhe ka fituar vendin e parë, ndërsa nga komuniteti boshnjak nuk është propozuar asnjë nxënës. Ajo në vazhdim tha se DKA-ja kur e shpall thirrjen për gara të diturisë e shpall për të gjitha komunitetet në gjuhën e tyre.

**Mirsada Behluli:** – tha se dua t’ju njoftoj se ka qenë një delegacion nga UNMIK-u në takim me kryetarin e kryeqytetit ku të pranishëm kemi qenë drejtori për siguri, unë si kryesuese e komitetit, ku ne një grup intelektualësh kemi ardhur në përfundim, mirëpo nuk e di se a është përfunduar hartimi i kurrikulës së sistemit arsimor, nëse nuk ka përfunduar dhe nëse ka vend për në të ardhmen të shqyrtohet që të gjithë fëmijët e të gjitha komuniteteve kishte me qenë mirë që të mësojnë gjuhët e të gjitha komuniteteve, të cilat jetojnë aty për shkak të bashkëjetesës së komuniteteve shumicë dhe joshumicë.

**Lindita Rexhepi:** – tha se pasi që ka shumë prindër të interesuar për regjistrimin e fëmijëve nëpër kopshte shtroi pyetjen se a do të dalë së shpejti konkursi apo si është plani qysh kisha mundur me ju dhënë përgjigje të interesuarve.

**Klaudia Mula:** - sa i përket pyetjes së znj. Rexhepi lidhur me konkursin për regjistrimin në kopshte tha se konkursi do të dalë për klasat e para dhe regjistrimin nëpër kopshte, mirëpo ju kisha lutur që ta respektoni vendimin e zonimit ku banoni pasi që nuk do të ketë tolerim në këtë aspekt. Pra duhet të plotësohen kriteret në konkurs, edhe në rast se plotësohet numri në atë zonë atëherë do të propozohet që të shkohet në shkollën më të afërt të asaj pjese të zonimit.

**Feim Osmani:** - duke iu drejtuar znj. Mula shtroi pyetje lidhur me paralelet e ndara në shkollën “Nexhmi Mustafa” në Besi e sidomos në fshatin Rimanishtë se a keni informata për konkursin që ka të bëjë me regjistrimin e nxënësve në klasën e parë për këtë vit shkollor, si dhe a do të ketë nxënës të mjaftueshëm për të vazhduar këtë paralele apo keni planifikuar diçka tjetër. Kurse pyetja e dytë ka të bëjë me paralelen e ndarë në fshatin Lebanë, ku në takimin që kam pasur me drejtorin e DKA-s kam bërë kërkesë drejtpërdrejtë që nxënësit e shkollës në fshatin Trudë, të cilët e kanë të organizuar dhe të paguar transportin nga komuna, të orientohen në shkollën në fshatin Lebanë, që ajo shkollë të mos shuhet, pasi që komuna e ka krijuar edhe një Bashkësi lokale të cilës i përkasin këto fshatra. Ndërsa çështja e cila është me shumë rëndësi ka të bëjë me rritjen e cilësisë së mësimdhënies duke e rritur numrin e nxënësve dhe konkurrencës.

**Klaudia Mula:** – lidhur me diskutimin e z. Osmani tha se ky është një problem i paraqitur në disa shkolla kohën e fundit, që d.m.th ka rrënie të dukshme të nxënësve dhe është duke u diskutuar në drejtori dhe nuk është që ka ndonjë vendim lidhur me këtë çështje, mirëpo sidoqoftë unë do ta përcjell tek drejtori dhe në ndërkohë do ju njoftojmë.

#### **Pika e katërt**

**Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Kadastrit dhe legalizimit, Gent Begolli (evidentimi i pronave për komunitetet joshumicë, mënyra e trashëgimisë, korrigjimet e numrave personale në certifikatat e pronës)**

Për shkak të mospjesëmarrjes së drejtorit të drejtorisë përkatëse në takim kjo pikë shtyhet për njërën prej mbledhjeve të ardhshme.

#### **Pika e pestë**

**Analiza e punës dhe shqyrtimi i aktiviteteve të Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2026**

**Betim Abdullahu:** – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se kjo pikë i takon anëtarëve të komitetit të mandatit të kaluar, pasi që në atë kohë unë e kam përfaqësuar Zyrën për komunitete. Mirëpo kjo në njëfarë forme ka të bëjë me raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete, se çka është bërë gjatë vitit 2025. Ai mes tjerash tha se nëse keni bërë ndonjë përmbledhje të raportimit vitin e kaluar, atëherë mundemi me e lënë për takimin e ardhshëm me e sjell, pasi që këtu është edhe Raporti i punës së ZKKK-ës për vitin 2025. Ndërsa sa i përket raportit të punës së ZKKK-ës tha se unë kam kërkuar nga ZKKK me e sjell për arsye se është bërë shkëputja prej muajit nëntor, dhjetor nuk është mbajtur asnjë mbledhje për ta parë se çka është punuar në ZKKK gjatë vitit 2025.

**Oktay Kurtesh:** – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës shtroi pyetje se a duhet të jetë ndonjë grup punues që të raportojë apo kush duhet të raportojë lidhur me këtë pikë.

**Nenad Miladinovic:** - lidhur me diskutimin e z. Abdullahu tha se pajtohem me diskutimin, ne kemi pasur raportin e komitetit për vitin 2025, ku ai raport ka përfshirë shumicën e kërkesave dhe çka është bërë dhe çka nuk është bërë. Pra kisha me propozuar që mos të vonohemi shumë në këtë pikë të rendit të ditës, prandaj kisha propozuar që të formojmë një grup punues, i cili kishte me përgatitur Planin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026.

**Oktay Kurtesh:** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se unë kisha propozuar që njëri prej anëtarëve në grupin punues për hartimin e Planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2025 të jetë Nenad Miladinovic.

**Betim Abdullahu:** – lidhur me grupin punues për hartimin e Planit të punës tha se do të ishte mirë që të jemi të kyçur të gjithë ne anëtarët e komitetit. Pra do të ishte mirë që ta lëmë me u takuar një ditë dhe ta bëjmë krahasimin me planin e punës të vitit të kaluar.

**Feim Osmani:** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se meqë kemi një raport narrativ të punës për vitin 2025, me siguri edhe planin e veprimit të komitetit besoj se mundemi me e hartuar në mbledhje të rregullt për gjysmë ore, kështu që besoj se nuk na paraqet problem. Ai në vazhdim tha se meqë një pjesë e madhe e anëtarëve kanë qenë edhe në mandatet e kaluara mund të na ndihmojnë shumë dhe besoj se për gjysmë ore mundemi me hartuar planin e punës së komitetit për vitin 2026, në mbledhjen e rregullt dhe nuk kemi nevojë që të caktojmë takim tjetër.

### **Pika e gjashtë**

#### **Raporti i punës së ZKKK-ës për vitin 2025**

**Mirsada Behluli:** – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se meqë i kemi dy anëtarët e ri në komitet znj. Lindita Rexhepi dhe z. Feim Osmani, desha t'i njoftoj se ne kemi bërë një raport të punës së Komitetit për Komunitete, i cili është hartuar në formë të skriptës ku janë përfshirë të gjitha aktivitetet dhe punët e komitetit, të cilat janë të argumentuara, ku dhe kam dëshirë që t'ju jap si dhuratë nga komiteti. Ajo mes tjerash në pika të shkurta të pranishmit i informoi se në Komunën e Prishtinës sipas regjistrimit të fundit të popullsisë jetojnë 4449 pjesëtarë të komuniteteve joshumicë, ku nga komuniteti serb janë 770, nga komuniteti boshnjak janë 356, nga komuniteti ashkali janë 427, nga komuniteti rom janë 57, nga komuniteti goran janë 188, dhe të tjerët janë 515.

**Betim Abdullahu:** – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se nuk e di se a e keni të gjithë raportin e punës së ZKKK -ës për vitin 2025, meqë tani jam në një rol tjetër këtu dhe këtë raport e kam bërë unë pasi që deri më 9 dhjetor 2025 kam qenë udhëheqës i ZKKK-ës. Prandaj nëse keni ndonjë pyetje unë jam këtu t'ju jap përgjigje, mirëpo nuk kisha për të hyrë me e lexuar për shkak të kohës. Mirëpo çfarë do që të shihni në raport mund ta diskutojmë edhe në takimin e radhës.

### **Pika e shtatë**

#### **Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre**

**Adnan Ajeti:** – sa i përket komunitetit rom krejt është në rregull.

**Nenad Miladinovic:** – sa i përket kësaj pike të rendit të ditës tha se mjafton të titullohet vetëm për gjendjen e komuniteteve në bashkësitë e jo të përfshihet edhe sigurisë, pasi që sa i përket sigurisë kemi Komitetin për Siguri dhe aty i shfaqim të gjitha brengat që kanë të bëjnë me sigurinë. Ndërsa sa i përket komunitetit serb nuk kemi problem, meqë Bërnica është e banuar me banorë multietnik.

**Betim Abdullahu:** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se për herët e ardhshme vetëm e ndërroni këtë pjesën që i përket sigurisë, pra të jetë Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen në bashkësinë e tyre.

**Kimeta Shok:** – sa i përket sigurisë nuk kemi problem, vetëm se kisha me propozuar që sa i përket ndihmave me dru zjarri që të fillohet më herët e të mos ndodh si vitin e kaluar ku vetëm një familje nga komuniteti goran i ka marr drutë. Ajo në vazhdim tha se ndoshta kishte me qenë mirë që t’ju ndihmohet financiarisht pasi që disa prej tyre jetojnë në ndërtesa dhe nuk i përdorin drutë.


**Mirsada Behluli:** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se pajtohem me znj. Shok sepse çdo vit po na ndodhin probleme dhe mundësisht do të ishte mirë që të ju ndihmohet financiarisht, pasi që shumica janë përfitues për drunj, por nuk i marrin për shkak se duhet të organizojnë transportin e nuk kanë të holla t’i paguajnë.

**Betim Abdullahu:** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se sa i përket druve të zjarrit ZKKK është u varur nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale. Gjithmonë listat i kemi bërë bashkë edhe asnjë emër ZKKK nuk e ka heq që ta përjashtojë prej rastit të përfitimit të druve. Pra arsyeja është Drejtoria e Mirëqenies Sociale, ndërsa sa i përket ZKKK-ës tha se shumicën e projekteve i ka financuar si p.sh materiale higjienike për familjet e komuniteteve, pastaj materialet didaktike dhe shkollore për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian, pako ushqimore për familjet e komuniteteve etj. Pra kemi ndihmuar aq sa kemi pasur mundësi me buxhet që kemi pasur si ZKKK. Ai në vazhdim tha se propozoj që në takimin e ardhshëm të ftohet drejtoresha e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale znj. Adelina Sahiti që me u dakorduar prej tash për dru zjarri mos me na e shkurtuar buxhetin në fund të vitit siç ka ndodhur më parë.

*Takimi i radhës do të mbahet më dt. 23.6.2026*

**Procesmbajtësja  
Lendita Spahija**

**Kryesuesi i Komitetit  
Oktay Kurtesh**



Faqe 8 nga 8